

VENDIM
Nr. 802, datë 12.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT
TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 3.2, shifra, “... 605 498 838 (gjashtëqind e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë ...” zëvendësohet me shifrën “... 1 265 498 838 (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë ...”;

b) Pas pikës 3.2 shtohet pika 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.3 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 387 370 974 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku